

Ristrukturimi i Qeverisë së Kosovës dhe zgjerimi e kabinetit qeveritar

EFIKASITET APO AKOMODIM?



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

01/2026

Më 11 shkurt 2026, Kuvendi i Kosovës miratoi përbërjen e re të Qeverisë së Kosovës, e cila përbëhet nga tre zëvendëskryeministra dhe 19 ministri. Krahasuar me mandatin 2021–2025, ku qeveria funksiononte me 13 ministri, kemi një rritje të ndjeshme të strukturës ekzekutive.

Në vitin 2021, reduktimi i ministrive ishte arsyetuar publikisht me nevojën për rritje të efikasitetit dhe ulje të korrupsionit. Në vitin 2026, ndonëse numri i ministrive është rritur me shtatë ministri të reja, për këtë rritje nuk është paraqitur asnjë analizë publike që të justifikojë këtë ndryshim strukturor.

Nga gjithsej 22 zyrtarë që përbëjnë kabinetin qeveritar, 2 janë dënuar me vendim gjyqësor për vepra penale (përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm dhe përdorim i paautorizuar i armës), 4 janë aktualisht të përballur me aktakuza penale aktive (përfshirë veprat penale të përdorimit të armës apo mjetit të rrezikshëm, pengimit të personit zyrtar, korrupsionit, sulmit dhe kanosjes), 4 kanë qenë të akuzuar në të kaluarën për vepra penale, por rastet e tyre kanë përfunduar me aktgjykim lirues ose parashkrim, ndërsa për 4 zyrtarë të tjerë ka pasur raportime publike për përfshirje në skandale, dyshime për konflikt interesi ose performancë të dobët.

19 ministri

(nga 13 në mandatin 2021–2025)

Zgjerimi i kabinetit është bërë pa analizë funksionale, buxhetore dhe pa plan tranzicioni institucional.

Katër ministri janë ndarë në tetë sosh.

Ministria e fuzionuar (2021–2025)

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike

Ministria e Infrastrukturës, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Ministria e fuzionuar (2021–2025)

Ministria e Financave

Ministri për Punë, Familje - janë shtuar Familja dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare)

Ministria e Punëve të Brendshme

Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Ministria e Kulturës dhe Turizmit

Ministria e Sportit dhe Rinisë

Përbërja aktuale e Qeverisë



Albin Kurti
Kryeministër



Saranda Bogujevci
Ministre e Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit



Glauk Konjufca
Zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporës



Elbert Krasniqi
Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal



Donika Gërvalla-chwarz
Zëvendëskryeministre e dytë dhe ministre e Ministrisë së Drejtësisë



Blerim Gashani
Ministër i Ministrisë së Sportit dhe Rinisë



Fikrim Damka
Zëvendëskryeministër i tretë për Çështje të Pakicave dhe Bashkëpunim



Fitore Pacolli Dalipi
Ministre e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Hekuran Murati
Ministër i Financave



Armend Muja
Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



Andin Hoti
Ministër i Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare



Dimal Basha
Ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit



Ejup Maqedonci
Ministër i Ministrisë së Mbrojtjes



Mimoza Kusari Lila
Ministre e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit



Xhelal Sveçla
Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme



Artane Rizvanolli
Ministre e Ministrisë së Ekonomisë



Lulëzon Jagxhiu
Ministër i Ministrisë së Digjitalizimit dhe Administratës Publike



Nenad Rašić
Ministër i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim



Arben Vitia
Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë



Rasim Demiri
Ministër i Ministrisë për Zhvillim Rajonal



Hajrulla Çeku
Ministër i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

Ky ndryshim kërkon një shqyrtim kritik nga perspektiva e qeverisjes së mirë, racionalitetit institucional dhe koherencës politike.

2. Mungesa e arsyetimit publik dhe racionalitetit institucional

Në asnjë moment gjatë prezantimit të kabinetit të ri qeveritar nuk është paraqitur një dokument strategjik, analizë funksionale apo raport vlerësimi që të dëshmojë se modeli me 13 ministri ka dështuar apo ka qenë i pamjaftueshëm.

Rritja e numrit të ministrive nuk është shoqëruar me:

- analizë të performancës së ministrive të fuzionuara;
- analizë të ndikimit buxhetor;
- vlerësim të kapaciteteve administrative;
- apo një plan të tranzicionit institucional.

Në mungesë të këtyre elementeve, zgjerimi i kabinetit paraqitet më tepër si vendim politik sesa si reformë e bazuar në evidencë.

3. Mungesa e dimensionit të integritetit evropian

Në prezantimin e qeverisë së re nuk është diskutuar asnjë pikë referuese substanciale lidhur me ristrukturimet institucionale dhe ndërlidhjen me procesin e integritetit evropian.

Kjo është veçanërisht problematike në kontekstin kur Kosova mbetet i vetmi vend në rajon pa status kandidat dhe kur procesi i integritetit kërkon konsolidim institucional, jo fragmentim.

4. Mungesa e referencës institucionale për dialogun

Po ashtu, në strukturën e re qeveritare nuk është paraqitur një pikë e qartë referuese për procesin e dialogut me Serbinë. Derisa në mandatin e kaluar qeveria ka pasur një Zv. Kryeminister për dialog, në mandatin aktual ky prioritet ka mbetur pa adresim institucional. Duke qenë se dialogu është i ndërlidhur drejtpërdrejt me avancimin e Kosovës në procesin e integritetit evropian, mungesa e një strukture apo pozite të qartë qeveritare për këtë proces krijon paqartësi institucionale dhe deficit koordinimi.

5. Konkludime

Nga analizë e thjeshtë mund të nxirren këto konkludime:

- Rritja e numrit të ministrive është bërë pa një analizë të mirëfilltë që të dëshmojë se kjo është struktura më efektive për menaxhimin e përgjegjësi qeveritare.
- Zgjerimi i kabinetit implikon në mënyrë indirekte se modeli me 13 ministri nuk ka qenë efektiv, por kjo nuk është shoqëruar me asnjë raport vlerësimi apo auditim institucional.
- Argumenti i mëparshëm për uljen e korrupsionit përmes reduktimit të ministrive bie në kundërshtim me zgjerimin aktual, duke ngritur pikëpyetje nëse struktura e mëparshme ka dështuar në këtë drejtim.
- Ristrukturimi është bërë pa aranzhime të qarta rregullative dhe nënligjore për ndarjen e përgjegjësi, burimeve njerëzore dhe resurseve financiare.
- Buxheti i prezantuar në Kuvend nuk paraqet ndarje të qartë buxhetore sipas ministrive të reja, duke krijuar paqartësi mbi koston reale të zgjerimit të numrit të ministrive.
- Kryeministri nuk ka paraqitur një program qeverisës që reflekton strukturën e re të digastereve qeveritare, duke lënë boshllëk strategjik në orientimin e politikave publike.

Në mungesë të arsyetimit publik dhe një analize të mirëfilltë të (mos)funksionimit të qeverisë, rritja e numrit të ministrive lë hapësirë për interpretimin se zgjerimi i kabinetit i ngjason me shumë nevojës për akomodim politik të bashkëpunëtorëve dhe bashkëpartiakëve, e jo nga nevoja funksionale e reformimit institucional.